

VENDIM
Nr. 673, datë 29.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 217, DATË 11.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.4.2014, PËR ÇËSHTJEN “KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 DHE 15075/09), TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8/1, e vendimit nr. 217, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, riformulohet, si më poshtë vijon:

“8/1. Efekti financiar, i parashikuar në paragrafin e dytë, të pikës 1, të këtij vendimi, në shumën 135 564 492 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga fondi i kontingjencës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama